



Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2020 - 31 Dhjetor 2020

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10 - 14

Raport i Auditorëve të pavarur

Drejtuar Kryesisë së Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare bashkëngjitura të “Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “IRDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2020, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 7-14

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2020 të “Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të opinionit

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshëm në Kosovë. Në mungese të librave kontabël dhe shënimeve të mirëfillta ne e kishim të pamundur aplikimin e procedurave të auditimit ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Ashtu siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare të bashkëngjitur, detyrimet dhe fondet e subjektit politik tejkalojnë asetet e SP për 941.65 euro me 31 Dhjetor 2020 si pasojë ka një mos barazim në mes të aseteve të prezantuara dhe burimeve të financimit. Në mungesë të shënimeve përkatëse ne e kishim të pamundur të përcaktojmë nëse SP ka mbivlerësuar burimet e financimit apo ka nënvlerësuar asetet e prezantuara.
- Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur që për shpenzimet e ushqimit, reprezentacionit, komunikimit dhe karburantit, në shumicën e rasteve SP ka blerje me kupona fiskal dhe nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, që do të mund të arsyetonin dhe mbështesnin shpenzimet e ndodhura. Për vlerën e shpenzimeve prej 967.50euro SP nuk posedon asnjë dëshmi mbështetëse.
- SP IRDK nuk ka regjistrime në librin e arkës të transaksioneve të kryera për blerjet ose furnizimet me para të gatshme në vlerë prej 6,110.00 Euro të cilat mjete janë tërhequr nga llogaria rrjedhëse bankare për pagesat e shpenzimeve me para të gatshme. Pa këto informata dhe transaksione të arkës që nuk janë të regjistruara dhe të klasifikuara sipas kategorive të shpenzimeve të raportuara ashtu siç kërkohet me ligjin për financimin e subjekteve politike, ne e kishim të pamundur të verifikojmë me saktësi nëse transaksionet e raportuara janë të sakta dhe valide, të rexhistruara drejt dhe se i takojnë aktivitetit të vet SP IRDK.
- Subjekti Politik nuk ka prezantuar të hyra nga donacionet në të holla, në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka pranuar apo jo donacione në të holla.

-Subjekti Politik nuk ka prezantuar të hyra nga kontributet në natyrë, në mall dhe shërbime. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka pranuar apo jo kontributet në natyrë, në mall dhe shërbime.

Theksim i çështjes

- Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrolle të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e vet (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.



Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k


Besa Sahitaj Berisha
Auditore Ligjore
6 Tetor 2021



Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2020	Me 31 Dhjetor 2019
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	1,499.43	3,778.41
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		1,499.43	3,778.41
Total pasuritë		1,499.43	3,778.41
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		3,778.41	3,778.41
Suficiti / (deficiti) i vitit		-2,278.98	
Total Ekuiteti		1,499.43	3,778.41
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	
Të hyrat e shtyera	5	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	941.65	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		941.65	0.00
Gjithsej detyrimet		941.65	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		2,441.08	3,778.41

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2020	2019
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		31,500.00	2,887.45
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5	0.00	2,000.00
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		31,500.00	4,887.45
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	19,680.45	
Shpenzimet e transportit	2	3,204.35	300
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2	10,584.80	0.00
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	
Blerja e mallrave	2	0.00	
Shpenzimet e përgjithshme	2	309.38	809.04
Shpenzimet e ndryshme	2	0.00	
Gjithsej shpenzimet për vitin		33,778.98	1,109.04
Suficiti / (deficiti) për vitin		-2,278.98	3,778.41

1. Informata te përgjithshme

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është subjekt Politik i Certifikuar nga KQZ, SP ka selinë në Pejë.

Akronimi: IRDK

Udhëheqja: Elbert Krasniqi (Kryetar i partisë)
Përfaqësues Financiar: Skender Qorri

Adresa e subjektit politik: Pejë

Pasqyrat financiare të Iniciativa e Re Demokratike të Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare në bankën RBKO.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	17,881.22	17,881.22	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	613.77	613.77	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	613.77	613.77	0.00
Tatimet në të ardhura personale	571.69	571.69	0.00
Beneficionet tjera			
Gjithsej	19,680.45	19,608.64	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	2,488.53	2,488.53	0.00
Karburantet	715.82	715.82	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	3,204.35	3,204.35	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			
Ushqimi			
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta			
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	10,584.80	10,584.30	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	10,584.80	10,584.30	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020

Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës			
Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës			
Telefoni, interneti dhe posta			
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	309.38	309.38	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	309.38	309.38	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	33,778.98	33,778.98	0.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla						

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		në euro
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet					

Shenime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme		

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë		

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera		

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra		

